



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:189808
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05523278

C.nr.564/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridike të paditësit H.M nga fshati Vrajak, komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson Av. R.H nga Rahoveci, kundër të paditurës D, me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seance, me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit H.M nga fshati Vrajak, komuna e Rahovecit, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës D, me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro,

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi H.M nga fshati Vrajak, komuna e Rahovecit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka ushtruar padinë kundër të paditurës D, me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Av. R.H nga Rahoveci, me parashtresë të veçantë prej datës 21.11.2022 e ka tërhequr padinë.

Andaj kjo gjykatë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditësit është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.564/2022, më 28.03.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.